



Prishtinë, 02 maj 2013
Kodi i ZRRE-së: V_533_2013

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, Nenit 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.6, dhe 2.16 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, (Ligji Nr. 03/L-185);
- Rregullën për vendosjen e çmimeve për Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Operatorin e Tregut (Rregulla për çmimet e OST/OT), 2011;
- Parimet e përcaktimit të ngarkesave për transmision nxjerrë nga ZRRE-ja me 18.07.2012; dhe
- Kërkesën e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT.Sh.A) të datës 05.04.2013 drejtuar ZRRE-së për shqyrtim dhe aprovim të dokumenteve “Metodologjia e Ngarkesave për Shfrytëzimin e Rrjetit të Sistemit të Transmisionit (TNUOS)”, “Metodologjia e Ngarkesave të Operatorit të Sistemit” dhe “Metodologjia e Ngarkesave të Operatorit të Tregut”.

në seancën e mbajtur me datë 02 maj 2013, nxori këtë:

VENDIM

I. APROVOHEN:

- “Metodologjia e Ngarkesave për Shfrytëzimin e Rrjetit të Sistemit të Transmisionit (TNUOS)”
- “Metodologjia e Ngarkesave të Operatorit të Sistemit”
- “Metodologjia e Ngarkesave të Operatorit të Tregut”

ARSYETIM

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 05.04.2013 ka pranuar kërkesën nga KOSTT.Sh.A (Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut) për aprovim të dokumenteve “Metodologjia e ngarkesave për shfrytëzimin e rrjetit të sistemit të transmisionit (TNUOS)”; “Metodologjia e Ngarkesave të Operatorit të Sistemit (OS)” dhe “Metodologjia e Ngarkesave të Operatorit të Tregut (OT)”.
- o ZRRE ka qenë e kyçur gjatë tërë kohës së hartimit të dokumenteve dhe ka dhënë komentet e veta gjatë takimeve drejtpërdrejt, por dhe në formë të shkruar.
- o Me 25.02.2013 Zyra e Rregullatorit për Energji i ka ofruar KOSTT-it komentet e veta në Metodologjitë e Ngarkesave për TNUOS, OS dhe OT.
- o Me 05.04.2013 KOSTT Sh.A ka derguar përgjigjet e komenteve të ZRRE-së, si dhe versionin e azhurnuar final të Metodologjive për Ngarkesa për TNUOS, OS dhe OT.
- o KOSTT SH.A, në pajtim me Nenin 6, paragrafin 4 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Operatorit të Tregut, do të publikojë në ueb faqen e tij këto Metodologji.



- II. Bordi i ZRRE-së duke marrë parasysh dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi dhe pas shqyrtimit të këtyre Metodologjive, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e aprovimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar